



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

VENDIM
Nr. 220, datë 26.05.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi dhe Suela Lika, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: Nenet 283/1-286/1, 114/2-291/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Rexhep Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 283/2 i K.Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Maksim Qirjazi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: Plagosje e rëndë me dashje e kryer në bashkëpunim.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Klejda Çapja dhe Pëllumb Zaimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Vrasje me dashje mbetur në tentativë.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Viktima: {...}; Akuza: Dhunë në familje, Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës.
4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me të mitur në konflikt me ligjin: {...}; Akuza: Vjedhje; Të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Vjedhje; Viktima të veprës penale: {...}, {...}.
5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me Padites: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Ankim ndaj vendimit të pezullimit të gjykimit.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia dhe Iliba Bezati, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}, etj.; I paditur: Shoqëria “Five Star Konstruktion sh.p.k.”; Objekti: “Zgjidhje kontrate sipërmarrje, lirim dorëzim trualli”.
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka dhe Margarita Buhali, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}, etj.; Objekti: “Lirim dhe dorëzim sendi”.
3. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Prodhimi dhe shitja e narkotikëve.
4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali (relatore), Skënder Damini dhe Sokol Ngresi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Pastrim i produkteve të veprës penale.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja dhe Valbon Çekrezi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Shlyerja e dëmit dhe fitim i munguar.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 150-25 i Kodit Penal

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Fuat Vjerdha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}dhe {...}; Akuza: Kryerja e veprave penale të parashikuara nga nenet 287/1 germa (a), (b) dhe (d), 28/4, 333/a/2 si dhe 334 te Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR